Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/28
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** akreditimi dhe validimi i Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" me adresë: Veternik, p.n. Prishtinë, Republika e Kosovës, për Kualifikimin:

   1.1. **Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore,** Niveli V sipas KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 60 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje SH.P.K" me datë 14.04.2023 ka parashtruar në AKK kërkesën për akreditim dhe validim të institucionit me kualifikimin: Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore niveli V sipas KKK, e cila është protokolluar dhe ka marrë numër 01/172. AKK ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të institucionit dhe pasi aplikacioni i ka plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi e njëjta është aprovuar nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së dhe është vazhduar tutje me procedurat tjera të procesit. AKK nga lista e eksperteve të aprovuar nga Këshilli Drejtues ka zgjedhur ekipin vlerësues për këtë institucion, i cili nga data 24.10.2023 deri 07.10.2023 ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje SH.P.K". Ekipi i eksperteve me datë 08.11.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion, ndërsa me datë 16.11.2023 ekipi vlerësues ka përpiluar raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje SH.P.K". Anëtaret e Këshilli Drejtues shqyrtuan në detaje raportet vlerësuese të eksperteve dhe konstatuan se në pjesën e parë të raportit vlerësues është rekomanduar akreditim me kusht për institucionin por se ekspertet kanë vlerësuar se dokumentacioni ka mangësi të cilat janë paraqitur në pika të ndryshme të raporteve për akreditim dhe validim që ka përgatitur ekipi i

eksperteve. Ekipi i eksperteve thekson faktin se ka qenë në dilem nëse duhet rekomanduar mos akreditim, por Këshillit Drejtues i kanë rekomanduar që institucioni të akreditohet me kusht për periudhë 1 vjeçare, duke i dhënë një afat njëvjeçarë për plotësimin e kushteve. Ekipi i eksperteve vlerësues ka theksuar se: " ka dhënë disa rekomandime dhe ka bërë disa kërkesa QPGJ-së gjatë vizitës, por disa prej tyre nuk janë përfill as në dokumentacionin shtesë që është sjellë përmes AKK-së.

Ekipi i eksperteve me rastin e vlerësimit të stafit të QPGJ, në raportin vlerësues për akreditim, ka vlerësuar se bazuar në CV-të që institucioni ka ofruar, mësimdhënësit nuk kanë përvojë për punën me fëmijë me nevoja të veçanta, e disa prej tyre nuk kanë fare përvojë në arsim. Sipas eksperteve në takimin dhe bisedën me stafin e QPGJ na është thënë se ata kanë përvojë, por në kërkesën e bërë përmes AKK, ata nuk kanë ofruar dokumente shtesë që të vërtetojnë këtë. Ekipi i eksperteve ka vlerësues se një pjesë e stafit ka nevojë për trajnime shtesë për të ofruar shërbime për kandidatë. Në stafin e mësimdhënësve ka mësimdhënës që nuk ka përvojë pune. Për këtë arsye kanë rekomanduar që institucioni të angazhoj ekspert kredibil jashtë institucionit për të bërë trajnimin e këtij stafi aktual në fushën e punës, ose QPGJ të angazhoj staf tjetër me kualifikim adekuat të fushës.

Ekipi i eksperteve në raportin vlerësues për akreditim të institucionit në pjesën e 3 pika 3 e raportit sa i përket kriterit për stafin e nevojshëm për ofrim, vlerësim dhe certifikim kanë vlerësuar se mësimdhënësit e QPGJ kanë përvojë të konsiderueshme pedagogjike ashtu siç dëshmohet përmes CV, por ata nuk kanë përvojë direket me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, e disa prej tyre nuk kanë fare përvojë arsimore. Prandaj, sipas eksperteve ky kriter tek pjesa 3 pika 3 e raportit për akreditim plotësohet pjesërisht. Sipas anëtareve të Këshillit Drejtues institucioni nuk ka plotësuar kritereve dhe standardeve sipas dispozitave ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK, ashtu siç parashihet në neni 10 pika 1.11 i Udhëzimin administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Bazuar në raportin përfundimtar të eksperteve për akreditim pjesa tre (3) e raportit ku kërkohet që institucioni të ketë infrastrukturën e nevojshme për ofrim, vlerësim dhe certifikim, kriter i cili duhet të përmbushet nga ana e institucionit bazuar në Udhëzimin administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, ky kriter është vlerësuar se plotësohet pjesërisht duke theksuar faktin se planimetria e objektit nuk parasheh dhe nuk ka kapacitet për akomodimin e 200 kandidatëve, sepse ka vetëm dy salla me hapësirë për 26 kandidatë, gjë që pamundëson arritjen e numrit të orëve brenda vitit akademik për një vit. Ndërsa arsyetimi i institucionit ishte se një pjesë e mësimit do të realizohet në distancë (online). Ekspertet kanë konstatuar se institucioni nuk ka hapësirë publike të mjaftueshme të oborrit dhe parkingut dhe krijon pak mundësi për punë në grupe. Po ashtu KD analizoj edhe pikën 6 të pjesës së katër të raportit vlerësues të eksperteve për akreditim lidhur me politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara e cila sipas eksperteve nuk plotësohet sepse: QPGJ nuk ka ofruar ndonjë dëshmi rreth metodave vlerësues për kategorinë e personave me nevoja të veçanta arsimore. Institucioni nuk ka rregullore të brendshme për kushtet dhe mjetet për vlerësim të këtyre personave. Prandaj,. Këshilli Drejtues bazuar në raportin vlerësues të eksperteve pika 3 e pjesës së tretë të raportit për akreditim ku kemi plotësim të pjesërishëm të këtij kriteri konsideron se institucioni nuk mund ofroj kualifikim, vlerësoj dhe certifikoj kandidatë pa pasur stafin e nevojshëm për të ofruar kualifikimin asistent me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Këshilli Drejtues konstatoj se kriteri për njohjen dhe transferin e kredive të fituara nga kandidatët nuk plotësohet, ku ekspertet në pikë 8 të raportit vlerësues për akreditim kanë dhënë arsyet për këtë vlerësim ku theksohet se institucioni nuk njeh kreditë paraprake dhe nuk transferohen.

Sipas anëtarëve të Këshillit Drejtues pika 4 e pjesës së tretë e raportit vlerësues për validim sipas vlerësimit të eksperteve plotësohet pjesërisht sepse kualifikimi nuk ka paraqitur një përmbajtje të moduleve, por vetëm ka bërë emërtimin e tyre dhe rezultatet mësimore të synuara. Prandaj, ekipi i eksperteve ka vlerësuar se QPGJ nuk ka ofruar një plan program të detajuar për kualifikimin pasi nuk ka syllabus e as përmbajtje të programit. Tek pjesa e arsyetimit për këtë pikë ekspertet vlerësuan se institucioni nuk ka prezantuar material i cili do të ligjërohet në orët e një moduli. Pas vizitës në institucion ekipi i eksperteve ka paraqitu shqetësimi dhe i ka dhënë kohë institucionit të dorëzoj dëshmi sa i përket kësaj pjese por ne raportin përfundimtar është konstatuar se institucioni nuk ka ofruar asnjë informatë, qoftë një model të vetëm, një temë mësimore apo një njësi mësimore të vetme. Në raportin e tyre ekspertet kanë konsideruar se nuk duhet të fillohet puna pa pasur një material mësimor për mësimdhënësit dhe kandidatët. Andaj, Këshilli Drejtues thekson faktin se institucioni nuk ka përmbushur kriteret ashtu siç parashihen me Udhëzimin administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Institucioni edhe pas afatit të dhënë nga ekspertet nuk ka ofruar dokumente me të cilat ka dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së pas analizimit në detaje të raporteve vlerësuese të eksperteve të jashtëm bazuar në të gjeturat në raportet vlerësuese të ekspertëve për institucionin "Qendra profesionale për Gjithëpërfshirje" si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të Udhëzimit administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, me shumicë votash vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së